



Pranuar / Dorezuar Prilimje / Prodato Received / Delivery	13. 09 2018	Viti god year	8
Organ / Mësi Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5245/2018		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 218 / 2018
Datë: 31.08.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 dhe nenit 19 paragrafëve: 1, 5 nënparagrafit 5.1, 6 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi shqyrtoi raportin me rekomandimin e Kolegjit të Këshillit për mbikëqyrjen e procedurës së avancimit për pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Inspektime” në Komunën e Gjakovës, Këshilli në mbledhjen e shtatëmbëdhjetë (XVII) të mbajtur më datë 31.08.2018 mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e rregullt** procedura e avancimit për pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Inspektime” në Komunën e Gjakovës, sepse është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjakovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, si dhe të njëjtin t’ua dërgoj kandidatëve në procedurë të avancimit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Arsyetim

1. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 22.06.2018 nëpërmjet shkresës me numër protokolli 3512/2018 është njoftuar nga Komuna e Gjakovës për shpalljen e konkursit të brendshëm të datës 22.06.2018 për pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Inspektime”, duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, respektivisht

shkresës së aprovimit për autorizim të shpalljes së brendshme të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil të datës 20.06.2018, me kriteret e konkursit *“Diplomë Universitare nga fusha e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësi, ekonomi, pedagogji ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare”*, ndërsa nën numrin rendor 3 kriteri i kërkuar ka qenë: *„Diplomë Universitare (Fusha e Juridikut, Sigurisë, Ekonomik, Kriminalistike, Teknologji, Bujqësisë, Informatike, Veterinës, Menaxhim të Emergjencave, Administratë Publike etj)”*, ndërsa në konkursin e datës 22.06.2018 si kriter të kualifikimit e ka përcaktuar kriterin si në vijim: *„Diplomë Universitare (Fusha e Juridikut, Sigurisë, Ekonomik, Kriminalistike, Teknologji, Bujqësisë, Informatike, Veterinës, Menaxhim të Emergjencave, Administratë Publike ,etj)”*, e që pranimit të dëshmime zyrtare nga organi i punësimit me datë 09.08.2018, formularit të kërkesës në SIMBNJ, është konstatuar që në kërkesën e datës 01.06.2018 të bërë nga organi i punësimit gjegjësisht udhëheqësi i personelit dhe Kryetari i Komunës, ka qenë pikërisht ky kriter i kualifikimit, dhe i njëjti kriter *„Diplomë Universitare (Fusha e Juridikut, Sigurisë, Ekonomik, Kriminalistike, Teknologji, Bujqësisë, Informatike, Veterinës, Menaxhim të Emergjencave, Administratë Publike ,etj)”*, është miratuar nga Drejtori i DASHC-së me datë 20.06.2018, në ora 15:29:28, por që pastaj gabimisht në autorizimin e lëshuar no kopje fizike është përfshirë edhe kriteri tjetër i kualifikimit.

2. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 25.06.2018 nxjerr Vendimin V.nr.242/2018 me të cilin bënë emërimin e Kolegjit lidhur me vëzhgimin e procedurës së avancimit për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Inspektime”* në Komunën e Gjakovës.
3. Kriteret dhe kushtet e përcaktuara në konkursin e shpallur për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Inspektime”* në Komunën e Gjakovës, kanë qenë:
 - *Diplomë Universitare (në fushën e Juridikut, Sigurisë, Ekonomik, Kriminalistikë, Teknologji, Bujqësisë, Informatike, Veterinës, Menaxhim të Emergjencave, Administratë Publike ,etj).*
 - *Minimum 4 vite përvojë pune profesionale.*
4. Komuna e Gjakovës, më datë 10.07.2018 ka përcjell tërë materialin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit. Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Gjakovës, me datë 26.06.2018, duke u bazuar në nenin 7 paragrafin 1 dhe 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, ka nxjerr Vendim me numër 112/02-18366 për formimin e Komisionit Përzgjedhës prej 5 anëtarëve, me këtë përbërje:
 - *Engjull Berisha – Drejtor i Bibliotekës “Ibrahim Rugova”, Kryesues,*
 - *Mergim Delija- Drejtor i ShFMU “Dëshmorët e Dushkajes”, në Gjakovë, anëtar,*
 - *Kastriot Sada – Drejtor i Shkollës së Muzikës “Prenk Jakova”, anëtar,*
 - *Armend Behluli –Shefi Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar dhe*
 - *Merita Bokshi – Drejtoreshë e shkollës „Kadri Kusari”, anëtare.*
5. Këshilli gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se për pozitën *“Udhëheqës i Sektorit për Inspektime”*, kanë aplikuar pesë (5) kandidatë si në vijim: 1. *Afrim Luzha*; 2. *Artan Hoxha*, 3. *Dafina Thaqi*, 4. *Hazbije Lluka* dhe 4. *Shkumbin Kumnova*.

6. Këshilli gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve dhe e ka përpiluar listën e ngushtë prej katër (4) kandidatëve si në vijmë: 1. *Afrim Luzha*; 2. *Artan Hoxha*, 3. *Dafina Thaqi* dhe 4. *Hazbije Lluka*.
7. Këshilli gjatë shqyrtimi të dokumentacionit, ka konstatuar se testimi me shkrim është mbajtur me datën 14.06.2018 dhe iu kanë nënshtruar tre (3) kandidatë të cilët kanë qenë të përfshirë në listën e shkurtër si: *Afrim Luzha*, *Artan Hoxha* dhe *Hazbije Lluka*, kurse *Dafina Thaqi* nuk është paraqitur në testim me shkrim..
8. Këshilli ka konstatuar se testi me shkrim ka qenë i përpiluar në pajtim me nenin 36 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.
9. Bazuar në nenin 19 paragrafin 4 dhe 5 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryesuesja e Kolegjit për mbikëqyrje ka paraqitur raportin me rekomandimin që të aprovohet si e rregullt procedura e avancimit për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime" në Komunën e Gjakovës.
10. Këshilli gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të dërguar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës me datë 27.08.2018, ka konstatuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil për vendin e punës "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime" në Komunën e Gjakovës, ka rekomanduar kandidatin Artan Hoxha, i cili posedon:
 - **Diplomën** me numër 452/09 të datës 09 qershor 2009 të lëshuar nga Universiteti AAB, me të cilin dëshmohet se me datë 17.04.2009 ka mbaruar studimet themelore dhe ka fituar titullin „Bachelor i Kriminalistikës“.
 - **Përvoja e punës të kandidatit të përzgjedhur:** sipas Vërtetimit me numër 112/205/2018 të datës 26.06.2018 të lëshuar nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Gjakovës konstatohet se Artan Hoxha është duke punuar në pozitën „Inspektor i Tregut“ në Komunën e Gjakovës nga data 17 prill 2015 e deri më tani; sipas Vërtetimit me numër 124/12 të datës 07.09.2012 të lëshuar nga Kolegji Bizensi, konstatohet se Artan Hoxha ka punuar si staf akademik me kontratë me normë të plotë pune në këtë kolegji në vitin akademik 2012/2013 dhe sipas Vërtetimit me numër 370/14 të datës 22.07.2014 të lëshuar nga Kolegji Bizensi, konstatohet se Artan Hoxha ka punuar si asistent i grup lëndëve nga Menaxhimi i Emergjencave në këtë kolegji në vitin akademik 2013/2014.
11. Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datën 31.08.2018 pasi shqyrtoj raportin e paraqitur nga Kolegji për mbikëqyrje, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
12. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës, Kryetari i Këshillit dhe personat kompetent i ndërmarrin veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit;
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës; dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI

Kryetar i Këshillit